

A je bërë objekt i dhunës në një lidhje të afërt?

Dhuna në lidhje të afërt mund të jetë më shumë gjëra. Ndonjëherë është një partner që të bën ty objekt. Ndonjëherë janë të tjerët nga farefisi. Po ashtu, mund të jenë edhe fëmijët që i bëjnë objekt prindërit e tyre. Dhuna mund të jetë si dhunë psikike, fizike dhe seksuale. Kjo mund të jetë kur dikush:

- Të quan ty të keq/keqe dhe të ligë ose ti mund të dëgjosh se ti je i keq/e keqe dhe e bezdisshme.
- Të shtynë, godet, shqelmon ose të lëndon në ndonjë mënyrë tjetër
- Të kontrollon dhe të kufizon, të detyron të bësh gjëra që ti nuk dëshiron t'i bësh
- Të detyron ty të përshtatësh sjelljen tënde ose të ndryshosh stilin tënd të jetës
- Të detyron të bësh diçka seksualisht
- Merr kontrollin e ekonomisë tënde

Ti ke të drejtë për mbrojtje dhe për mbështetje

Çdokush mund të goditet nga dhuna në një lidhje të afërt. Ti që je bërë objekt do të marrësh informacion, mbrojtje dhe mbështetje dhe do të pranohesh me respekt dhe me ndjeshmëri. Ke të drejtë për këtë gjë. Nëse ke fëmijë, në atë rast edhe fëmijët kanë të drejtë për mbështetje.

Ti mund të kesh ndihme me:

- Biseda mbështetëse
- Mbrojtje dhe banim të përkohshëm
- Ndihmë ekonomike
- Mbështetje në kontaktet me organet e tjera zyrtare, p.sh. policinë.

Na kontakto ne që të ndihmojmë ty. Nëse ti dëshiron, ti mund të jesh anonim.

Në rast të rrezikut akut, telefono gjithmonë 112.

Kontakto:

- **Veprimtarinë:** Vuxenenhetens mottagningsgrupp
- **Numri i telefonit:** 08-58169000
- **Uebfaqja:** www.upplands-bro.se
- **Adresa e selisë/vizitës:** Furuhällsplan 1, Kungsängen

Andra i kommunen som erbjuder stöd - Albanska

Komunat e tjera të cilat ofrojnë mbështetje

Këtu i gjen të dhënat e kontaktit në komunat e tjera të cilat mund të japin mbështetje, p.sh. Kujdestaria e grave ose Kujdestaria e të pësuarve nga krimi.

- **Veprimtarinë:** Kvinnojouren Anna
- **E-post adresa:** info@kvinnojourenanna.se
- **Numri i telefonit:** 08-58240999
- **Uebfaqja:** www.kvinnojourenanna.se

Mbështetje kombëtare

Kvinnofridslinjen 020-50 50 50

Telefon mbështetës kombëtar për ty që ke përjetuar kërcënim ose dhunë. Ti mund të telefonosh edhe pse nuk e flet suedishten. Telefonata nuk kushton gjë dhe të dhënat nuk shihen në faturën e telefonit. Ti mund të jesh anonim.

www.kvinnofridslinjen.se

BRIS 116 110

Telefon mbështetës për ty që je i ri/e re. Ti mund të shkruash në çat ose të dërgosh e-mail. Ti mund të jesh anonim.

www.bris.se

RFSL:s brottsofferjour 020-34 13 16

Telefon mbështetës për ty që je homoseksual, biseksual, transperson ose queer dhe je bërë objekt i krimit ose e dhunës.

www.rfsl.se/brottsoffer/

Terrafem 020- 52 10 10

Telefon mbështetës për ty që je bërë objekt i dhunës. Ti mund të kesh mbështetje në shumë gjuhë të ndryshme. Telefonata nuk kushton gjë dhe të dhënat nuk shihen në faturën e telefonit. Ti mund të jesh anonim.

www.terrafem.org

Brottsofferjouren 0200-21 20 19

Telefon mbështetës për ty që je bërë objekt i krimit. Ti mund të telefonosh edhe nëse ti nuk e flet suedishten.

www.boj.se